

Ndër gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në secilën prej shtatë gjykatave themelore treguan se ishte e lehtë të i qaseshin informacionit në lidhje me lëndët e tyre;
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në secilën gjykatë themelore pretenduan se informacioni i marrë nga gjykatat ishte paksa i dobishëm ose shumë i dobishëm;
- Shumica dërmuese e përdoruesve të shërbimeve të secilës gjykatë themelore deklaruan se ishte shumë e lehtë t'a gjenin sallën e gjykimeve ose zyrën që e kërkonin;
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës në secilën gjykatë themelore nuk e dinin nëse në ambientet e gjykatës kishte kuti për ankesa;
- Si të përdoruesit e shërbimeve të gjykatave të anketuar ashtu edhe pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve (DFG) thanë se kishte tavolina për informim, por pjesëmarrësit në DFG treguan se shpesh askush nuk gjendej në ato tavolina;
- Shumica dërmuese e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave, si nga komuniteti shumicë ashtu edhe nga ato joshumicë, nuk e përdorin si burim informacioni faqen e internetit të gjykatës;
- Përdoruesit e shërbimeve të gjykatave nga komunitetet joshumicë pohuan se faqet e internetit të gjykatave janë të përkthyer në gjuhën e tyre amtare, por që cilësia e përkthimit duhet të përmirësohet, etj.